



HULUMTIM MBI TË DREJTAT PRONËSORE DHE TRASHËGIMORE TË GRAVE NË RAJONIN E POLLOGUT

Përgatiti:
Memet Memeti

Janar 2017



Citizens for change!

Përmbajta

I.	HYRJE	3
II.	KONTEKSTI TEORIK	4
III.	METODOLOGJIA	5
IV.	KORNIZA JURIDIKE	6
V.	HULUMTIMI NË TERREN	7
VI.	KONKLuzionET	25
VII.	REKOMANDIMET	26
VIII.	BURIME TË KONSULTUARA	27
IX.	ANEKS	28

Tabela e figurave dhe grafikoneve

Grafikoni 1	Statusi martesor i grave të anketuara	100
Grafikoni 2	Statusi i punësimit	110
Grafikoni 3	Të punësuarit në familje	111
Grafikoni 4	Kuj i është regjistruar prona në familjen tuaj	122
Grafikoni 5	Mënyra se si është fituar pasuria	132
Grafikoni 6	A keni trashëguar pasuri nga prindërit	133
Grafikoni 7	Trashëgmia (sipas përkatësisë etnike)	144
Grafikoni 8	Arsyet pse kam marr trashëgimi	166
Grafikoni 9	Qëndrim pse nuk kam marr trashëgiminë	176
Grafikoni 10	Përkrahja nga prindërit	177
Grafikoni 11	Vajza ka trashëguar pasurinë	18
Grafikoni 12	Vajza ka trashëguar (sipas përkatësisë etnike)	18
Grafikoni 13	Qëndrimet për trashëgiminë	200
Grafikoni 14	Qëndrimet mbi patundshmërinë	211
Grafikoni 15	Kush do ta trashëgoj pronën time	221
Grafikoni 16	Si do ta ndaj trashëgiminë (përkatësi etnike)	232
Grafikoni 17	Pse nuk marrin trashëgimi	254
Tabela 1	A keni marr trashëgimi (sipas variableve)	155
Tabela 2	Kush do ta trashëgoj pasurinë (sipas variableve)	244

Hulumtimi është punuar në suaza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”, zbatuar nga Shoqata Forumi i gruas Tetovë, në korniza të programës CIVICA Mobilitas.

CIVICA Mobilitas është projekt i Agjencionit Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), të cilin e zbatojnë Niras nga Danimarka, Qendra Maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar (MCMS) dhe Instituti Suedes për administratë publike (SIPU)..

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë për fuqizim ekonomik të grave në rajonin e Pollogut, kurse qëllimi specifik është të nxisë dhe kontribuojë në arritjen e të drejtave pronësore dhe thasëgimore të grave në rajonin e Pollogut.

I. HYRJE

Një prej dimensioneve të diskriminimit gjinor është edhe qasja e jo e barabartë në trashëgimi dhe pronë. Është vërtetuar se mohimi i të drejtës në trashëgimi ndikon dukshëm në sigurinë ekonomike dhe pavarësinë e gruas në shoqëri. Hulumtimet e ndryshme sjellin në pah se arsyet kyçe për mungesën e qasjes në pronë janë tradita dhe doket që përjashtojnë gruan nga ky proces. Në shumë shoqëri struktura patriarkale çon në përjashtimin e gruas nga e drejta në trashëgimi si rezultat i normave dhe dokeve që zbatohen nga gjenerata në gjeneratë.

Edhe në Republikën e Maqedonisë një prej sfidave kyçe të barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas është qasja në trashëgimi dhe pronë si *condicio sine qua non* për një pjesëmarrje kuptimplotë në proceset socio-ekonomike në shoqëri. Duhet theksuar se korniza juridike garanton të drejtat e barabarta për burrat dhe gratë, por ndikimi i normave shoqërore, dokeve, traditës, kushtet ekonomike dhe niveli i arsimimit janë barrierë serioze për fuqizimin e gruas në këtë sferë.

Edhe pse të barabartë para ligjit, si rezultat i kodit mental tradicional shumë gra në Republikën e Maqedonisë ende nuk e trashëgojnë pronën. Madje, të shpeshta janë rastet kur ato heqin dorë në mënyrë vullnetare nga trashëgimia familjare, duke ua lanë mundësinë që këtë pasuri ta gëzojnë anëtarë të tjerë të familjes.

Qasja në të drejtat pronësore dhe trashëgimia e pronës janë nga faktorët e shumtë të përdorur për të treguar nivelin e barazisë së grave në një shoqëri. Në këtë kontekst, analiza e paraqitur në vijim do të japë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar hipotezën se gratë në Republikën e Maqedonisë në përgjithësi dhe gratë në rajonin e Pollogut në veçanti vazhdojnë të ndjejnë rëndë peshën e kulturës dhe traditës qoftë edhe nëpërmjet qëndrimeve personale ose qëndrime të përgjithshme sipas të cilave burrat janë ata, të cilët duhet ta bartin barrën e përgjegjësisë pasurisë dhe si të tillë ata duhet të trashëgojnë pronën në familje.

Situata me të drejtat trashëgimore/pronësore të gruas në Republikën e Maqedonisë mund të trajtohet në dy dimensione edhe atë dimensionin juridik dhe social, pra kornizën juridike që garanton të drejtën në trashëgimi/ pronësi dhe realizimin e kësaj të drejte në praktike. Përkundrejt faktit se korniza juridike trajton të drejtën në trashëgimi, kjo e drejtë nuk aplikohet si rezultat i normave dhe dokeve shoqërore. Kjo situatë ndikon në fuqizimin ekonomik të gruas, statusin e saj në shoqëri. Si pasojë gratë kanë qasje të kufizuar në asete dhe mjete financiare.

Hulumtimi kryesisht përqendrohet në dimensionin social, pra arsyet për një situatë të tillë të grave në rajonin e Pollogut. Qëllimi i hulumtimit është të identifikoj arsyet e diskrepancës në qasjen në trashëgimi në mes burrave dhe grave si dhe të ofroj rekomandime për përmirësimin e qasjes së grave në trashëgimi/pronë.

II. KONTEKSTI TEORIK

E drejta në pronë dhe asete si asnjë problem tjetër sjell në pedestal problemin e paralelizmit në mes normave shoqërore dhe të drejtës pozitive.

Shoqëria si fenomen përbëhet prej burrave dhe grave, dhe nëse analizohet në këtë rrafsh secili prej tyre ka mënyra të ndikojë në pushtet dhe të kontrollojë veprimet e pushtetit. Sipas Sewell (2010) ndikimi i secilit prej nesh varet nga normat shoqërore dhe nga ineterakcioni etabluar në mes individëve.

Kështu, nëse shoqëria është patriarkale, burrat do të kenë ndikim dhe kontroll ndaj grave pasi që kushtet, struktura patriarkale nuk sigurojnë mundësi që gratë të realizojnë ndikim dhe të kenë kontroll dhe qasje tek resurset.

Për tu tejkaluar kjo situatë nevojitet qasje proaktive e shtetit në determinin e një kornize juridike jo vetëm që do jetë jodiskriminuese por edhe do të ofroj masa afirmative. Në këtë kontekst, Qasje e bazuar në të drejta niset nga kjo premisë, pra shteti nuk duhet të diskriminoj gjatë dizajnit të politikave dhe kornizës juridike. Por, problem kryesor në shumë shoqëri nuk është korniza juridike por zbatimi i kornizës juridike në jetën e përditshme.

Në shumicën e rasteve shoqëritë nuk kanë gatishmëri të ndryshojnë normat shoqërore diskriminuese. Qasje e bazuar në të drejta (Right based approach) përqendrohet në fuqizimin dhe pjesëmarrjen si mekanizma për realizimin e të drejtave. Mirëpo, aplikimi i kësaj qasjeje në praktikë sfidohet nga mënyra sesi pushteti të ndikojë në shoqëri nën presion të dokeve vlerave dhe traditës në shoqëri. Në shumë vende ballafaqohemi me modelin patriarkal ku burrat dominojnë sistemin dhe ku gratë nuk perceptohen si të denja të ushtrojnë pushtet dhe të kenë qasje në resurse dhe si pasojë participimi dhe fuqizimi i gruas është tejet i kufizuar. Kjo nënkupton se ndryshimi i praktikave

diskriminuese mund të ndodh vetëm nëse përmirësohet qasje e gruas në procesin e vendimmarrjes dhe në resurse.

Barazia gjinore si koncept është e pamundur të realizohet nëse nuk ndërthuren komponentët e qasjes së barabartë të gruas në asete, që tërthorazi nënkupton qasje në pronë dhe trashëgimi. Në këtë kontekst Raporti UNDP për zhvillim njerëzor potencon se: "Barazia gjinore do të duhet të jetë pjesë përbërëse e strategjive të shteteve për reduktimin e varfërisë njerëzore dhe kjo nënkupton fuqizimin e gruas duke siguruar të drejta dhe qasje në pronë, kredi dhe mundësi për punësim".¹

Ngjashëm raporti i Bankës Botërore Gjinia e Zhvillimit (2001) nënvizon se „ gratë në vazhdimësi vazhdojnë të kenë shumë pak kontroll në resurset produktive, dhe këto divergjenca do të ndikojnë negativisht në zhvillimin dhe standardin jetësor të familjeve të tyre.²

Duke marr parasysh kornizën teorike të trendëve globale për fuqizim të gruas duket se është imanente një përqendrim më i madh nga politike bërësit dhe shoqëria civile në Republikën e Maqedonisë në çështjen e trashëgimisë dhe pronësisë si dimension kyç për barazinë gjinore në Republikën e Maqedonisë.

III. METODOLOGJIA

Hulumtimi është realizuar në dy dimensione, së pari në analizë të kornizës juridike që rregullon çështjen e të drejtës në trashëgimi në Republikën e Maqedonisë dhe dimensionin e dytë hulumtimi në terren, pra anketë të vajzave dhe grave në rajonin e pollogut në lidhje me qasjen në trashëgimi dhe pronë.

Hulumtimi u referohet burimeve primare (anketa) dhe sekondare(korniza juridike, raporte, të dhëna statistikore, korniza teorike) Forumi i Gruas ka dizajnuar metodologjinë hulumtuese me anë të ekspertit të angazhuar, me qëllim të matjes së qëndrimeve të grave në rajonin e Pollogut lidhur me çështjen e drejtës trashëgimore dhe pronësore. Detajet e hulumtimit që ndërlidhen me instrumentet e hulumtimit, qasjen, mostrën janë pasqyruar më poshtë në këtë dokument.

¹ Faqe 7, Human Development Report, UNDP 1997

² Faqe5, Engendering Development, World Bank 2001

IV. KORNIZA JURIDIKE

Duhet theksuar se korniza juridike në Republikën e Maqedonisë vendos bazamentin për barazi sa i takon të drejtave ekonomike dhe sociale. Në këtë kontekst Neni 9 i Kushtetutës thotë: Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore.³ Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.

Për më tepër kur trajtohet e drejta trashëgimore dhe pronësore patjetër duhet analizuar Ligjin mbi familjen, Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Ligji mbi trashëgiminë dhe Ligji mbi mundësitë e barabarta në mes burave dhe grave.

Kujdesi mbi barazinë gjinore vjen në pah me faktin se politikëbërësi në Republikën e Maqedonisë ka miratuar Ligj të veçantë mbi mundësitë e barabarta. Ligji në fjale rregullon çështjen e barazisë gjinore duke promovuar mundësi të barabarta të burrave dhe grave në sferën politike, ekonomike, sociale, arsimore.⁴ Ligji sanksionon terminologjinë e re si mundësi të barabarta, trajtim të barabartë si dhe mekanizmat për arritje e mundësive të barabarta. Ligji nuk parasheh dispozita të veçanta në lidhje me të drejtën në trashëgimi apo pronësi.

Ligji mbi Familjen rregullon dhe definon familjen si bashkësi e prindërve që kanë fëmijë.⁵ Fryma e parimit të barazisë është taksativisht e shprehur në këtë ligj, në këtë kontekst ligji stipullon se të gjitha raportet në familjen duhet bazuar në parimin e barazisë. Gjithashtu, Ligji mbi familjen stipulon të drejtën e bashkësive jashtëmartesore, pra çiftet që jetojnë më tepër se një vit së bashku të trajtohen si të martuar për sa i përket të drejtave pronësore.⁶ I njëjti Ligj rregullon të drejtat e fëmijëve duke nënvizuar se ndaj fëmijëve duhet të sillen në mënyrë të njëjtë por pa potencuar taksativisht dimensionin e gjinisë.⁷

Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nisat nga parimi i barazisë pasi që potencon këtë parim dhe ndarjen e barabartë por nuk rithekson taksativisht gjininë dhe trajtimin e veçantë të grave në lidhje me këtë çështje. Pra sipas ligjit mbi pronën, çdo individ pa marr parasysh nëse janë shtetas apo jo kanë të drejtë në qasje në pronë.⁸

Ligji mbi Trashëgimi poashtu nisat nga parimi i barazisë ku thuhet se të gjithë qytetarët janë të barabartë në procesin e trashëgimisë.⁹ Ligji stipulon mundësinë e përjashtimit të pasardhësve në

³ Neni 9, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

⁴ Neni 2, Ligji për mundësi të barabarta në mes burrave dhe grave, Gazeta Zyrtare e RM, nr.06/2012 nga viti 2012

⁵ Neni 3 dhe neni 6, Ligji mbi Familjen, Gazeta zyrtare e RM, nr.153 nga viti 2004

⁶ Neni 13, Ibid

⁷ Neni 8, Ibid

⁸ Neni 2, Ligji mbi Pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Gazeta zyrtare e RM, nr.35 nga viti 2010

⁹ Neni 3, Ligji mbi trashëgiminë

procedurë të trashëgimisë në kushte të veçanta si dhe të heqjes dorë nga trashëgimia.¹⁰ Rregullimi i këtillë i kësaj çështjeje në këtë mënyrë krijon hapësirë për marginalizim e grave në procesin e trashëgimisë dhe aplikimit të drejtës zakonore e jo të drejtës pozitive.

Mund të konkludohet se korniza juridike trajton si të barabartë burrat dhe gratë sa i përket trashëgimisë dhe çështjeve pronësore, por duhet theksuar se nuk trajtim të veçantë të kësaj problematike në dimensionin e gjinisë dhe ky vakum ligjor mundëson diskriminimin e vajzave dhe grave në këtë sferë.

V. HULUMTIMI NË TERREN

a) Rajoni i Pollogut të dhëna të përgjithshme

Rajoni i Pollogut nga Maj i vitit 2008 është etabluar si rajon planor sipas ligjit për zhvillim të barabartë rajonal dhe është një nga tetë rajonet në nivel të Republikës së Maqedonisë. Në këtë rajon bëjnë pjesë komunat: Tetova, Gostivari, Mavrova dhe Rostusha, Zhelina, Tearca, Bogovina, Vrapçishti, Jegunovca dhe Bërvenica.

Në territor prej 2416.91 km² shtrihen gjithsejt 184 vendbanime në të cilat jetojnë 319.916 banorë prej të cilëve 73.2% janë shqiptarë, 18.4% maqedonas, 5.7% turq, 1.6% rom, 0.01% vllahë, 0.32% serb, 0.08% boshnjak dhe 0.66% etnitete tjera. Sipas të dhënave të Entit statistikor prej numrit të përgjithshëm, 161005 janë burra dhe 158911 gra. Ky rajon është një prej rajoneve me pak të zhvilluara me një përqindje të lartë të papunësisë. Kështu, papunësia në vitin 2016 është 27.6% (burrat) respektivisht 35.6% (gratë).

Nëse analizohet papunësia sipas vendbanimit, papunësia e grave në vendbanimet urbane është 34.1% ndërsa në vendbanimet rurale është 36.7%.¹¹

b) Mostra e hulumtimit

Në këtë hulumtim janë anketuar 300 gra mbi moshën 18 vjeçare. Mostra është reprezentative meqenëse të anketuarit reflektojnë strukturën etnike, vendbanimet (dimensionin rural urban), moshën, nivelin arsimor dhe statusin martesor të vajzave dhe grave në rajonin e pollogut.

c) Qasja

Hulumtimi në teren është realizuar në bazë të pyetësorit, që është hartuar nga eksperti i angazhuar nga Forumi i Gruas dhe i ndarë në disa segmente. Pyetësi përbëhet nga pyetjet e përgjithshme, të dhëna mbi situatën në lidhje me pronën/trashëgiminë dhe qëndrimet e grave rreth

¹⁰ Nenet 128-133 Ligji mbi trashëgiminë

¹¹ *Enti Statistikor i RM, Regjionet në Republikën e Maqedonisë, 2016, qasje në Janar 2017*

trashëgimisë pronësore, pyetje që përpiqen të nxjerrin të dhëna nga gratë se cilat janë qëndrimet e tyre për trashëgiminë pronësore në përgjithësi duke u fokusuar më shumë në përcaktimin e sistemit të vlerave në shoqërinë për sa i përket trashëgimisë pronësore të grave.

Hulumtimi në terren është zhvilluar me 300 respondente në rajonin e Pollogut. Hulumtimi është bërë sipas metodës së rastit. Së pari është identifikuar grupi i përafërt në secilin komunë dhe vendbanim. Më pas është caktuar numri i anketave dhe është organizuar trajnim për anketuesit për realizimin e anketës. Metoda e rastit është përzgjedhur për këtë hulumtim për shkak se në rajonin e Pollogut nuk ka patur studime rreth qëndrimeve të grave mbi të drejtat pronësore dhe trashëgimore. Pyetësi i përdorur në këtë hulumtim është pyetësor i strukturuar, i përbërë nga 21 pyetje, të ndara në fusha të ndryshme tematike. Ai është dizajnuar për të përfshirë të dhëna sasiore dhe cilësore që do të siguronin informata mbi gjendjen demografike dhe socio-ekonomike të të anketuarve, si dhe përgjigje në lidhje me pikëpamjet dhe perceptimet e tyre në lidhje me drejtat pronësore dhe trashëgimore në rajonin e Pollogut.

Variablet

Përkatësia etnike – modalitetet: maqedonase, shqiptare, turke, vllehe, rome, serbe, boshnjak dhe të tjerë.

Vendbanimi- modalitetet: urbane dhe rurale

Mosha – modalitetet: 18-25 vjeç, 26-33 vjeç, 34-41 vjeç, 42-49 vjeç, 50 +

Statusi martesor- modalitetet: e martuar, e pamartuar, e divorcuar, e veje, në bashkësi jashtëmartesore

Arsimimi-modalitetet: nuk ka mbaruar shkollën fillore, ka mbaruar shkollën fillore, ka mbaruar shkollën e mesme, ka mbaruar fakultet, ka mbaruar studime posdiplomike

Statusi i punësimit – modalitetet: i punësuar në sektorin publik, i punësuar në sektorin privat, i punësuar në shoqërinë civile (sektori joqeveritar), bujk, amvise, pensionist, nxënës / student, e papunë, tjetër.

Të ardhurat mujore neto të familjes – modalitetet: deri 9000 denarë, nga 9001-15000 denarë, nga 15001-21000 denarë, nga 21001-27000 denarë, nga 27001-35000 denarë, nga 35001-41000 denarë, më shumë se 41001 denarë.

Numri i anëtarëve në familje – modalitetet: deri në 2 anëtarë, 3-4 anëtarë, 5-6 anëtarë, në shumë se 6 anëtarë

Rezultatet kryesore e këtij hulumtimi në këto fusha janë prezantuar në vazhdim, më tej vijon një përmbledhje e rekomandimeve të përgjithshme në lidhje me të drejtat trashëgimore dhe pronësore në rajonin e Pollogut.

ç) Pasqyrë e variableve

Përkatësia etnike - Duke dashur që në anketë të kemi përfaqësim adekuat të të gjitha komuniteteve mostra e anketës kujdes të veçantë i ka kushtuar variablit përkatësi etnik. Kështu, në këtë hulumtim nga gjithsej 300 të anketuar, 48% i takonin përkatësisë etnike shqiptare, 31,3% e të anketuarve i takojnë komunitetit maqedonas, 7,3 % komunitetit turk, 2,3% komunitetit romë, 2% komunitetit serb dhe 8,7% janë përcaktuar si të tjerë. Struktura e tillë e të anketuarve deri diku korrespondon me strukturën e popullatës sipas përkatësisë etnike. Strukturimi i gjetjeve në lidhje me të drejtat pronësore dhe trashëgimore sipas përkatësisë etnike është kyç meqenëse do të sjellë në pah dallimet eventuale në mes komuniteteve sa i takon praktikave të trashëgimisë. Gjetjet e diferencuara sipas këtij variabli sjellin në pah nëse ka nevojë për intervenime të veçanta në bazë të përkatësisë etnike në rritjen e vetëdijes së gruas dhe komuniteteve për të drejtat pronësore dhe trashëgimore.

Vendbanimi - Krijimi i qëndrimeve varësisht nga tipologjia e vendbanimeve sipas analizave të ndryshme sociologjike dhe gjinore luan një rol të rëndësishëm për të pasqyruar një dukuri dhe për të dizajnuar dhe për të targetuar intervenime specifike për vendbanimet urbane dhe rurale. Gjykojmë se një qasje e tillë është e domosdoshme në këtë studim ku trajtohet çështja e trashëgimisë pronësore nga këndvështrimi gjinor, respektivisht identifikimi i qëndrimeve të grave dhe vajzave sipas vendbanimit luan një rol të rëndësishëm për të përcaktuar trendin e ndryshimit të sistemit të vlerave në mikro nivele (komunitetet e vogla) sa i përket ndarjes së pasurisë. Në të shumtën e rasteve, në kontekstin e analizimit të çështjeve që kanë të bëjnë më gratë, treguesit primar të analizimit i referohen në bazë të qytetit, ngaqë për shkak të ndikimit të disa faktorëve social, pritja për ndryshimin e disa praktikave tradicionale në qytete është më e madhe. Edhe pse, jeta e qytetit, shpesh në banesa të vogla dhe të dendura ka kontribuar në prishjen e strukturës tradicionale të familjes, megjithatë, nuk mund të flitet për ndryshime rrënjësore për sa i përket dallimeve në mes fshatit dhe qytetit në analizimin e çështjes së trashëgimisë pronësore nga gratë duke përfshirë të gjitha komunitetet. Kështu, 69% e vajzave dhe grave të anketuara jetojnë në vendbanime rurale dhe 31% në vendbanimet urbane.


Arsimimi - Nëse analizohet struktura arsimore del në pah se: 3% e të anketuarve nuk kanë të përfunduar arsimin fillor, 24 % kanë përfunduar arsimin fillor, 35 % kanë arsim të mesëm, 33 % kanë arsim të lartë dhe vetëm 4% kanë arsim pasuniversitar. Hulumtimet sjellin në pah se një prej instrumenteve të fuqizimit të gruas është arsimimi. Hulumtimi synonte të trajtoj korrelacionin në mes nivelit arsimor të anketuarve dhe realizimit të të drejtës në trashëgimi dhe pronë.

Mosha e të anketuarve - Në këtë anketë përqindja më madhe e të anketuarve i takon grup moshës 34-41 vjeçare (25.7%), pason grup moshë 42-49 me 23.7%, moshë 50+ me 22%, pason grup moshë 26-33 vjeçare me 20.7% dhe përqindja më e vogël e të anketuarve i takon moshës 18-25 vjeçare me 8%. Dallimet mes gjeneratave janë çështje që janë objekt hulumtimi shkencor në kontekst të

trendëve, vlerave dhe shijeve. Hulumtimi synon të trajtojë çështjen e qasjes në trashëgimi duke analizuar dallimet në mes grupmoshave të ndryshme në lidhje me realizimin dhe perceptimin e problemit në fjalë.

Statusi martesor i grave të anketuara - Statusi social është determinantë e rëndësishme që ndërlidhet me të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve 72% janë të martuara, 16% nuk janë të martuara, 8% janë të veja, 2% e grave të anketuar janë të divorcuara dhe 1% jetojnë në bashkësi jashtëmartesore (Shih grafikun në vijim).


Grafikoni 1 Statusi martesor i grave të anketuara



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Statusi i punësimit - Hulumtimi sjell në pah faktin se qasja në tregun e punës është një prej faktorëve kyç për fuqizimin e gruas. Në kontekst të këtij hulumtim analizuar ndërlidhjen në mes statusit të punësimit dhe shfrytëzimit të së drejtës në trashëgimi dhe pronë. Sa i takon statusit të punësimit 35% janë të punësuar në sektorin publik, 22% të punësuar në sektorin privat, 21% janë amvise, 9% janë përgjigjur se nuk janë të punësuar, 8% pensioniste dhe 3% e të anketuarve janë studentë (Shih grafikun në vijim).


Grafikoni 2 Statusi i punësimit



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

Një nga pyetjet në pyetësor ndërlidhej me statusin socio-ekonomik të familjes, pra kush është i punësuar në familjen e të anketuarës. Kështu, 40% e të anketuarve deklaruan se të dy bashkëshortët janë të punësuar në familjen e tyre. Në 27% të familjeve të anketuara punon vetëm bashkëshorti, në 8.3% fëmijët (Shih grafikoni në vijim).

Grafikoni 3 Të punësuarit në familje




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

ç) Prona në familje

Titullari i pasurisë në familje - Një tregues tjetër i rëndësishëm i (mos) përfshirjes së grave në proceset vendimmarrëse në familje është poashtu edhe regjistrimi i pasurisë. Kësisoj, 68.7% e të anketuarve kanë deklaruar se pasuria e tyre është regjistruar në emër të bashkëshortit respektivisht babait. Në vetëm 13% të familjeve të përfshira në anketë pasuria është regjistruar në emër të gruas dhe 7.7% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë pasuri të përbashkët (Shih grafikonin në vijim). Duhet theksuar se kjo situatë është pasojë e faktit se edhe në familjen e saj por edhe pas martesës gruaja nuk ka qasje në pronë apo qasje në asete si bazament për fuqizim ekonomik.

Nga gjetjet mund të konkludohet se gratë në rajonin e Pollogut nuk kanë qasje në resurse ekonomike në rrjetin familjar. Tradita dhe doket në lidhje me trashëgiminë diskriminon vajzat dhe gratë në rajonin e Pollogut, me këtë ndikon në fuqinë e tyre ekonomike dhe statusin social në komunitet.


Grafikoni 4 Kujt i është regjistruar prona në familjen tuaj



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Mënyra se si është fituar pasuria - Një prej çështjeve tejet të rëndësishme e ndërlidhur me fuqizimin e gruas në komunitet është mënyra sesi është fituar pasuria. Rreth 35% e të anketuarve pasurinë e kanë fituar me trashëgimi, 1/5 e të anketuarve kanë deklaruar se pasurinë e kanë fituar me kontratë për shitblerje, rreth 21% e të anketuarve kanë fituar pasurinë si trashëgimtar të pasurisë së bashkëshortit (Shih grafikonin 5 në vijim).

Grafikoni 5 Mënyra se si është fituar pasuria




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

d) Trashëgimia

Hipoteza se gratë në Republikën e Maqedonisë në përgjithësi dhe rajonin e Pollogut në veçanti nuk shfrytëzojnë të drejtat ligjore në sferën e trashëgimisë vërtetohen me gjetjet në këtë hulumtim. Rezultatet sjellin në pah faktin se 87% e grave të anketuara në anketë nuk kanë trashëguar pasuri nga prindërit (Shih grafikonin në vijim).

Grafikoni 6 A keni trashëguar pasuri nga prindërit



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

Trashëgimia sipas përkatësisë etnike - Duke u nisur nga fakti se rajoni i Pollogut është një rajon multietnik ky bashkëjetojnë grupe të ndryshme etnike që në vete kanë kode kulturore identitare specifike është me rëndësi të indentifikohen dallimet dhe ngjashmëritë në implementimin e kornizës juridike të trashëgimisë dhe pronësisë në bazë të përkatësisë etnike. Duhet potencuar se nuk ka dallime të theksuar në mes komuniteteve më të mëdha që me një përqindje më të lartë statistikore ishin të përfshirë në anketë. Kështu, 84% respektivisht 85% të të anketuarave shqiptare dhe maqedonase nuk marrin trashëgimi (Shih grafikonin në vijim). Tek komunitetet më të vogla kemi situatë edhe më alarmante. Këto gjetje sjellin në pah se në rastin e komunës së Pollogut variabli përkatësi etnike nuk luan rol në perceptimin e gruas në lidhje me qasjen në trashëgimi gjegjësisht pronë.

Grafikoni 7 Trashëgimia (sipas përkatësisë etnike)



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

Trashëgimia në bazë të vendbanimit - Në pyetjen se a keni marr trashëgimi, sipas variablit urban/rural, duhet potencuar fakti se ekziston dallim në qasjen ndaj trashëgimisë. Derisa në vendbanimet rurale vetëm 9% e grave të anketuara kanë marrë trashëgimi, tek vendbanimet urbane kjo përqindje është dukshëm më e lartë (21%) apo çdo e 5-ta grua e anketuar ka marr trashëgimi. Përkundrejt faktit se rezultatet janë dëshpëruese, këto gjetje sjellin në pah se ka dallim në mes trajtimit të drejtës në trashëgimi në mes vendbanimeve rurale dhe urbane dhe që mund të jetë një indikator për intervenime me të fokusuar në vendbanimet rurale në të ardhmen.

Trashëgimia në bazë të moshës - Sa i takon moshës duhet potencuar se ekzistojnë dallime në realizimin e të drejtës në trashëgimi. Kështu, të anketuarit të grup moshave 42-49 me 19%, janë grup moshë që në krahasim me grup moshat tjera kanë qasje më të madhe në trashëgimi, përqindja më e ulët është tek grup moshë më e re 18-25 me vetëm 4%. Do të ishte interesante të analizohen arsyet e një diskrepancë të tillë. Me gjasë kjo mund të jetë rezultat i faktit se procedura trashëgimore realizohet pas vdekjes së prindërve dhe në këtë moshë pjesa dërmuese e të anketuarve në këtë moshë nuk janë ballafaquar me një situatë të tillë.

Trashëgimia në bazë të arsimimit- Sa i takon arsimimit të anketuarve mund të konkludohet se niveli i arsimimit është në korrelacion të drejtpërdrejt me qasjen në trashëgimi. Me fjalë të tjera, tek të anketuarit me nivele më të larta arsimore rritet përqindja e të anketuarve që kanë shfrytëzuar të drejtën në trashëgimi. Kjo gjetje është në pajtim me gjetjet në shoqëritë tjera ku pretendohet se gruaja e arsimuar është më e fuqizuar, ka më tepër vetëbesim, vetëdije dhe është më këmbëngulëse në realizimin e të drejtave në këtë sferë.

Statusi martesor - Sa i takon statusit martesor përqindja më ulët është tek gratë e veja (12%) më e larta tek gratë e divorcuara me 14% që mund të jetë edhe rezultat të mekanizmit mbrojtës të familjes për shkak të divorcit të vajzës. (Për më tepër shih Tabelën në vijim për gjetje sipas variableve).

Tabela 1 A keni marr trashëgimi (sipas variableve)


Vendbanimi	Variabli	Po	Jo
Vendbanimi	Urban	21%	74%
	Rural	9%	91%
Moshë	18-25 vjet	4%	96%
	26-33 vjet	15%	85%
	34-41 vjet	12%	88%
	42-49 vjet	17%	83%
	50+ vjet	12%	88%
Statusi martesor	E pamartuar	13%	87%
	E martuar	13%	87%
	E divorcuar	14%	86%
	E veje	12%	88%
	Bashkësi jashtëmartesore	0%	100%
Punësimi	Sektorin publik	12%	88%
	Sektorin privat	16%	84%
	Shoqëri civile	0%	100%
	Bujk	0%	100%
	Amvise	6%	94%
	Pensioniste	17%	83%
	Nxënës/Student	20%	80%
	Papunë	19%	81%
Tjetër	0%	0%	
Arsimimi	Arsimi fillor i papërfunduar	11%	89%
	Arsim fillor	11%	89%
	Arsim I mesëm	13%	87%
	Arsim të lartë (Fakultet)	14%	86%
	Arsim pas universitar (Master, Doktoratë)	1%	99%

Burimi: Pyetësori i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Trashëgimi: Arsyet e marrjes së trashëgimisë

Gratë që kanë marr trashëgimi u deklaruan për arsyet e marrjes së trashëgimisë. Kështu, 35.9% u deklaruan se kanë marr trashëgimi pasi që është e drejtë e tyre, 33.3% pasi që është e drejtë ligjore, 20.5% pasi në familjen e tyre është aplikuar kjo, 7.7% për shkak të presionit nga bashkëshorti dhe 2.6% për shkak të gjendjes së rëndë financiare (Shih grafikonin në vijim). Është interesante se rreth 2/3 e grave që kanë marr trashëgimi si arsye kanë deklaruar të drejtën e tyre për qasje në trashëgimin familjare.

Grafikoni 8 Arsyet pse kam marë trashëgimi




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Trashëgimia: Arsyet pse nuk kam marë trashëgimin

Të anketuarat që u përgjigjen negativisht pyetjes a kanë marë trashëgimi, u deklaruan për arsyet e mos marrjes së trashëgimisë. Rreth 42% e të anketuarve nuk kanë marë trashëgimi se në familjen e tyre tradicionalisht vajzat kanë qenë të përjashtuara nga trashëgimia. Çdo e 5-ta nuk ka marë për shkak të frikës nga përkeqësimi i raporteve me familjen. Rreth 15.3% të të anketuarve nuk kanë marë trashëgimi pasi që në familjen e burrit nuk kanë probleme financiare, pra nuk kanë nevojë për trashëgimi të tillë (Shih grafikonin në vijim). Gjetjet sjellin në pah rolin e dokeve dhe normave shoqërore në sjelljen e familjeve në rajonin e Pollogut në lidhje me modelin e ndarjes së trashëgimisë.

Grafikoni 9 Qëndrim pse nuk kam marë trashëgiminë




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Trashëgimia: Përkrahja nga prindërit

Një nga pyetjet e parashtruara ishte përkrahja nga prindërit në realizimin e drejtës në trashëgimi. Është interesante se 30% e grave të anketuara nuk kanë mendim, 24.3% nuk kanë aspak përkrahje dhe 14% kanë shumë pak përkrahje. Nga gjetjet mund konkludohet se 2/3 e të anketuarve nuk janë të kënaqur me përkrahjen ose nuk kanë mendim në lidhje me trashëgiminë.

Grafikoni 10 Përkrahja nga prindërit




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

A e ekziston në familjen tuaj rast kur vajza ka trashëguar pasurinë

Të anketuarit kanë reflektuar për rastet në familjen e ngushtë dhe bashkësinë/komunitetin e tyre ku vajza trashëgon pasuri dhe për qëndrimet e tyre nëse në të ardhmen mund të ndodhin raste të tilla. 12.3% e të anketuarve janë përgjigjur se ka patur raste të tilla në familjen e tyre, ndërsa 29.7% se ka patur raste të tilla në bashkësinë e tyre. Indikative dhe të njëjtën kohë pozitive është se 24% e të anketuarve gjykojnë se raste të tilla do të ketë në të ardhmen dhe vetëm 3.3% nuk besojnë se vajza në familjen e tyre do të ketë qasje në trashëgimi (Shih grafikonin në vijim).


Grafikoni 11 Vajza ka trashëguar pasurinë



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Nëse kryqëzohet pyetja paraprake me përkatësinë etnike, del në pah se 57% e maqedonaseve pretendojnë se vajza ka marë trashëgimi në bashkësinë e saj, tek shqiptarët kjo është konfirmuar vetëm nga 9% e të anketuarave. Gjersa 35% e të anketuarave shqiptare pretendojnë se nuk ka ndodhë por do të ndodhë në të ardhmen. Kjo përqindje është dukshëm më ulët me 14% te komuniteti maqedonas dhe komuniteti turk. Indikative është një përqindje relativisht e lartë tek të gjitha komunitet e të anketuarve nuk dinë për raste të tilla (18% tek komuniteti maqedonas deri tek 43% tek komuniteti rom)

Grafikoni 12 Vajza ka trashëguar (sipas përkatësisë etnike)



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

II. Qëndrimet e grave mbi trashëgiminë - Qëllimi primar i hulumtimit është të identifikohen qëndrimet e vajzave dhe grave të anketuara në lidhje shfrytëzimin e së drejtës në trashëgimi dhe pronë. Në këtë pjesë të dokumentit do të shpalosen gjetjet në lidhje me perceptimet e grave të anketuara rreth të drejtës në trashëgimi dhe pronësi.

Njëra nga pyetjet në këtë pjesë të pyetësorit përbehej prej disa deklaratave me të cilat të anketuarit duhet të pajtohen ose jo. Deklaratat ishin si vijon:

- Deklarata pozitive e trashëgueses negativisht do të ndikojë në raportet me familjen time primare (prindër, vëllezër)
- Vajza duhet të marrë të njëjtin trajtim në procedurën e trashëgimisë nga prindërit.
- Vajza nuk duhet të marrë më shumë se ½ nga ajo që fitojnë trashëgimtarët tjerë.
- Vajza nuk duhet të marrë pronë në bazë të trashëgimisë nga prindërit (prindër, vëllezër).

Nga hulumtimi del në pah se 44% e të anketuarve mendojnë se deklarata pozitive e trashëgueses do të ndikojë negativisht në raportet familjare. Për më tepër rreth 28% nuk kanë mendim për këtë çështje. Vetëm 28% nuk pajtohen me këtë deklaratë. Rezultatet e tilla sjellin në pah se për shumë familje deklarata pozitive është papranueshme dhe burim për mosmarrëveshje në mes anëtareve të familjes.

Rreth 2/3 grave të kyçura në anketë nuk pajtohen me deklaratën se vajza nuk duhet të merr pasuri, pra të anketuarat janë pro të drejtës për trashëgimi por nëse ndërlihet me pyetjen paraprake


gjykojnë se nëse marrin trashëgimi do të prishin raportet me anëtarët tjerë të familjes. Rreth 16% e të grave të anketuara pajtohen se vajza, gruaja nuk duhet të ketë të drejtë në trashëgimi nga prindërit.

Është interesante të theksohet se 51% e të anketuarve pajtohen me deklaratën se vajza nuk duhet të marr më shumë se 1/2 nga ajo që marrin trashëgimtarët tjerë dhe vetëm 23% taksativisht nuk pajtohen me këtë deklaratë.

Këto rezultate janë në linjë me gjetjet nga pyetja vijuese, kështu në pyetjen nëse pajtohen se vajza duhet të ketë trajtimin të njëjtë në procedurë trashëgimore vetëm gjysma e të anketuarve janë pajtuar me këtë qëndrim dhe gjysma tjetër ose nuk janë pajtuar (26%) ose nuk kanë patur mendim në lidhje me këtë çështje (Shih grafikun në vijim)

Perceptimet apo qëndrimet e të anketuarve sjellin në pah se kultura dhe tradita dominojnë perceptimin e gruas në rajonin e Pollogut sa i përket trashëgimisë dhe të drejtës në pronë. Për më tepër gjetjet sjellin në pah se rreth 50% të grave në rajonin e pollogut nuk janë të gatshme të kërkojnë respektimin e kësaj të drejte ligjore pasi që është në kundërshtim me vlerat tradicionale dhe nga frika e prishjes se raporteve në mes anëtarëve të familjes. Kur flitet për qasje të kufizuara, pra 1/2 në trashëgimi rritet edhe përqindja e grave që janë pro modelit të tillë që është edhe konform traditës islame, por edhe faktit se ekziston një model solidariteti familjar si rezultat i rrjeteve të fuqishme familjare ku djali mer obligim për kujdes ndaj prindërve dhe si rezultat merr hise më të madhe në krahasim me vajzën. (Shih grafikun në vazhdim).

Grafikoni 13 Qëndrimet për trashëgiminë




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Të anketuarit dhanë mendimin tyre për patundshmërinë dhe ndikimin e saj në fuqizimin e gruas dhe parandalimin e dhunës në familje.

Rreth 59% e të anketuarave pajtohen me deklaratën se pasuria e patundshme ndikon në përmirësimin të vetëbesimit të gruas. Është interesant se 30% nuk kanë mendim për këtë çështje. Ndërsa sa i përket deklaratës se pasuria e patundshme zvogëlon mundësinë për dhunë në familje 32.7% nuk kanë pajtohen me këtë deklaratë ndërsa 32.4% nuk kanë mendim me në lidhje me këtë çështje.


Grafikoni 14 Qëndrimet mbi patundshmërinë



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Nëse keni apo do të keni fëmijë kush do ta trashëgoj pronën. Gjykuam se do ishte interesante të merren mendimet e të anketuarve sesi do të ndanin trashëgimin me trashëgimtarët e tyre. Rreth 15% e vajzave dhe grave të anketuara do të diskriminon vajzat e tyre, duke lënë trashëgiminë vetëm djemve. Rreth 42% preferojnë ndarje te barabartë në mes vajzës dhe djalit. Rreth 28% nuk e përjashtojnë vajzën por mendojnë se vajza duhet të ketë hise më të vogël në krahasim me djalin. Këto gjetje sjellin në pah nevojën për një qasje proaktive të vendimmarrësve dhe shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes së gruas për nevojën e mosdiskriminimit të saj në këtë sferë.

Grafikoni 15 Kush do ta trashëgoj pronën time




Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Kush do ta trashëgoj pronën (Sipas përkatësisë etnike)-Nëse të dhënat diferencohen në bazë të përkatësisë etnike del në pah se tek të anketuarat e përkatësisë maqedonase, 44%, do ta ndanin pronën në mënyrë të barabartë, 37% do t'i jepnin vajzës një hise më të vogël sesa djalit, 9% do ta përjashtonin vajzën nga trashëgimia dhe vetëm 5% nuk kanë mendim për këtë çështje.

Për dallim nga ky komunitet, 1/5 e të anketuarve në komunitetin shqiptar nuk kanë mendim për këtë çështje, 35% do të ndanin pasurinë në mënyrë të barabartë, 24 % do t'i jepnin hise më të vogël vajzës në krahasim me djalin dhe 15% do ta përjashtonin vajzën nga trashëgimia.

Këto gjetje sjellin në pah faktin se tek ky komunitet normat religjioze nuk kanë aplikim të tillë sa që kemi supozuar (sipas këtyre normave vajzës i takon 1/2 e hises) sesa që kanë doket dhe normat shoqërore. Tek komuniteti turk 50% do t'i trajtonin vajzat në mënyrë të barabartë me djemtë, 18% do t'i përjashtojnë vajzat nga procesi i trashëgimisë dhe 32% gjykojnë se vajza duhet të ketë hise më të vogël se djali. Është interesante se tek komunitetit romë 29% nuk kanë mendim për këtë çështje (Shih grafikun në vijim). Gjetjet sjellin në pah se nuk ka dallime të theksuara nga aspekti etnik, se normat religjioze nuk kanë ndikim aq të madh sa që është menduar, se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve tek komuniteti shqiptar, romë nuk kanë mendim që do të thotë se duhet të punohet më tepër në aktualizimin e kësaj çështjeje dhe ngritjen e vetëdijes së gruas. Gjithashtu, rrethi familjar i solidaritetit në mes gjeneratave (tek të gjitha komunitetet) ku djali kujdeset për prindërit në moshën e tretë mund të jetë një nga arsyet për një perceptim të tillë, pra përjashtimin e vajzës apo hises më të vogël për vajzën.

Grafikoni 16 Si do ta ndaj trashëgiminë (përkatësi etnike)



Burimi: Pyetësori i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

Vendbanimi - Ka dallime të theksuara në perceptimet në mes grave që jetojnë në vendbanimet rurale dhe urbane. Kështu, gjersa 48% e grave në vendbanimet urbane deklarojnë se pasuria duhet të ndahet në mënyrë të barabartë, kjo përqindje është më e ulët të gratë që jetojnë në vendbanimet rurale (38%). Është interesante se çdo e 5-ta grua në vendbanimet urbane nuk din se si do të ndante pasurinë, ndërsa përafërsisht është e njëjtë përqindja e grave në bazë të variablit vendbanim që do të përjashtonin vajzat nga trashëgimia.

Mosha - Nëse analizohen rezultatet nga pikëpamja e moshës, del në pah se grup moshat më të reja janë më të prirur për të mos diskriminuar në krahasim me ato më të vjetra. Kështu gjersa grup moshë më e re 18-25 me 58% do ta ndaj pasurinë në mënyrë të barabartë, kjo përqindje tek grup moshë më e vjetër (50+ vjeçare) bie në vetëm 30%. Këto gjetje sjellin në pah një reflektim që bazohet në parimin e mos-diskriminimit të grup moshat e reja që duhet përkrahur dhe fuqizuar nga rrethi familjar dhe komuniteti për një vetëbesim më të madh të gruas në të ardhmen.

Statusi martesor - Parimi i barazisë gjen mbështetje më të madhe të gratë e divorcuara me 57%, pasojnë të anketuarat që nuk janë martuar me 51% dhe përqindja më e ulët është të gratë që janë bashkësi jashtëmartesore me 25%.

Arsimimi - Reflektimi pozitiv mbi ndarjen e pasurisë në mënyrë të barabartë është në korrelacion të drejtpërdrejt me nivelin e arsimimit. Kështu, gjersa tek gratë me nivel më të ulët të arsimimit, arsim fillor të pambaruar përqindja që mbështet ndarje të barabartë të trashëgimisë është 22%, kjo përqindje rritet tek gratë me nivel më të lartë arsimor duke arritur 62% tek gratë që kanë kryer arsim pasuniversitar. Këto gjetje janë pajtim me hulumtimet tjera që sjellin në pah se një prej mekanizmave për fuqizimin e gruas është arsimimi.

Tabela 2 Kush do ta trashëgoj pasurinë (sipas variableve)

	Variabli			Në mënyrë të barabartë	Vajza pjesë më të vogël se djali	Nuk e di
		Djemtë	Vajzat			
Vendbanimi	Urban	13%	2%	48%	18%	19%
	Rural	15%	1%	38%	33%	12%
Moshë	18-25 vjet	8%	0%	58%	13%	21%
	26-33 vjet	8%	2%	48%	27%	15%
	34-41 vjet	17%	0%	45%	25%	13%
	42-49 vjet	10%	3%	35%	32%	18%
	50+ vjet	24%	3%	30%	35%	8%
Statusi martesor	E pamartuar	6%	0%	51%	21%	21%
	E martuar	15.2%	2.3%	40.1%	29.0%	12.9%
	E divorcuar	0%	0%	57%	14%	29%
	E veje	20%	0%	32%	44%	4%
	Bashkësi jashtëmartesore	50%	0%	25%	0%	25%
Arsimimi	Arsimi fillor i papërfunduar	22%	0%	22%	33%	22%
	Arsim fillor	27%	0%	26%	34%	12%
	Arsim I mesëm	10%	2%	41%	32%	13%
	Arsim të lartë (Fakultet)	9%	3%	52%	21%	15%
	Arsim pas universitar (Master, Doktoratë)	8%	0%	62%	15%	15%

Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit "Fuqizimi ekonomik i gruas në rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë"

Nga të anketuarit u kërkuan të rangojnë arsyet përse gratë nuk komunitetin e tyre nuk kërkojnë trashëgimi. Me 1 u rangua arsyeja më pak e rëndësishme ndërsa me 9 arsyeja me e rëndësishme. Nga gjetjet del në pah se arsye me rëndësishme u rangua tradita, pason frika nga mosmarrëveshjet eventuale me anëtarët tjerë të familjes, më pas gjykimi i tyre se bëjnë gjen e duhur, frika se në rast divorcit nuk do të mund të kthehen në familje, pasojnë normat fetare, mungesa e vetëbesimit (Shih grafikun në vijim). Gjetjet në këtë pyetje janë indikativë dhe do të duhej të jenë një lloj udhërrëfyese për vendimmarrësit por edhe për shoqërinë civile për intervenimet eventuale në këtë sferë.

Grafikoni 17 Pse nuk marrin trashëgimi



Burimi: Pyetësor i strukturuar në korniza të projektit “Fuqizimi ekonomik i gruas ne rajonin e Pollogut nëpërmjet avokimit dhe promovimit të drejtës në pronë”

VI. KONKLuzionet

- Derisa në të drejtën zakonore pozita e gruas ka qenë e diskriminuar në aspektin e së drejtës së trashëgimisë, ligji aktual për trashëgiminë i Republikës së Maqedonisë njih barazinë gjinore në trashëgimi.
- Por, krahas ekzistimit të infrastrukturës ligjore, Republika e Maqedonisë në kontekstin e të drejtave të grave për trashëgimi përballet me vazhdimësinë e aplikimit të dokeve dhe normave shoqërore që aplikohen gjeneratë pas gjenerate.
- Edhe pse ligji në fuqi njih barazinë e plotë në trashëgimi, gjetjet sjellin në pah se gjatë shqyrtimit të trashëgimisë, gruaja heq dorë nga e drejta e trashëgimisë së saj.
- Për shkak të numrit të vogël të grave të përfshira në tregun e punës, të dhënat statistikore sjellin në pah se në rajonin e pollogut gratë më pak kontribuojnë në buxhetin e familjes krahasuar me burrat,
- Gratë në rajonin e Pollogut nuk kanë qasje në resurse ekonomike në rrethin familjar. Tradita dhe doket në lidhje me trashëgiminë diskriminon vajzat dhe gratë në rajonin e Pollogut dhe me këtë ndikon në fuqinë e tyre ekonomike dhe statusin social në komunitet.

- Gratë janë të vetëdijshme dhe të frikësuara për pasojat që mund t'i kenë në rast se ato kërkojnë realizimin e të drejtës së tyre për të trashëguar pronësinë. Ato nuk janë të gatshme të kërkojnë respektimin e kësaj të drejte ligjore pasi që është në kundërshtim me vlerat tradicionale dhe nga frika e prishjes së raporteve në mes anëtarëve të familjes.
- Në vetëm 13% të familjeve të përfshira në anketë pasuria është regjistruar në emër të gruas dhe 7.7% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë pasuri të përbashkët. Duhet theksuar se kjo situatë është pasojë e faktit se edhe në familjen e saj por edhe pas martesës gruaja nuk ka qasje në pronë apo qasje në asete si bazament për fuqizim ekonomik.
- Ka dallim në mes trajtimit të drejtës në trashëgimi në mes vendbanimeve rurale dhe urbane dhe që mund të jetë një indikator për intervenime me të fokusuar në vendbanimet rurale në të ardhmen.
- Sa i takon arsimimit të anketuarve mund të konkludohet se niveli i arsimimit është korrelacion të drejtpërdrejt me qasjen në trashëgimi. Me fjalë të tjera, tek të anketuarit me nivele më të larta arsimore rritet përqindja e të anketuarve që kanë shfrytëzuar të drejtën në trashëgimi.
- Këto gjetje sjellin në pah një reflektim që bazohet në parimin e mos-diskriminimit të grup moshat e reja që duhet përkrahur dhe fuqizuar nga rrethi familjar dhe komuniteti për një vetëbesim më të madh të gruas në të ardhmen.
- Në rajonin e Pollogut nuk ka dallime të theksuara në trajtimin e gruas në lidhje me trashëgiminë dhe pronë në bazë të përkatësisë etnike. Egziston trend diskriminimi i pranishëm tek të gjitha komunitetet etnike.

VII. REKOMANDIMET

- Komunitat që gravitojnë në rajonin e Pollogut, Komisionet për mundësi të barabarta në mes grave dhe burave në nivele komunale dhe mekanizmat tjera përkatëse për arritjen e barazisë gjinore dhe drejtat e njeriut, ta monitorojnë zbatimin e kornizës juridike mbi trashëgiminë.
- Të iniciohet debat publik nga shoqëria civile me qëllim të informimit të qytetarëve, konkretisht grave për të drejtën e tyre në trashëgimi.
- Analizë më të thuktë të kornizës juridike për të shqyrtuar mundësitë e ndryshimit dhe tejklaimit të grykave të ngushta me qëllim që të reduktohet hapësira për aplikim të së drejtës zakonore në këtë sferë.
- OJQ-të, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore, të iniciojnë fushata vetëdijësimi dhe informimi për të drejtat e grave në trashëgimi. Fushata duhet të dizajnojnë qasje specifike për vendbanimet rurale dhe urbane, komunitetet e ndryshme etnike dhe mekanizma të ndryshme informimi që do jenë të pranueshme për grup moshat e ndryshme.
- Komisioni për mundësi të barabarta në mes grave dhe burave dhe OJQ-të e grave të organizojnë trajnime për gjykatësit/et me qëllim të rritjes së ndjeshmërisë ndaj rasteve të cilat kanë të bëjnë me çështjet gjinore dhe trashëgiminë pronësore.

- Pushteti qendror dhe pushtetet lokale të zhvillojnë programe edukative të cilat në mënyrë të veçantë do t'i përfshijnë gratë në viset rurale në mënyrë që ato të mund ta realizojnë potencialin e tyre ekonomik.
- Pushteti qendror në bashkëpunim me bankat në RM, t'iu mundësojë grave marrjen e kredive me kushte të volitshme dhe fillimin e bizneseve të tyre, duke i ndihmuar ato me politika afirmative ekonomike në forma të ndryshme të bashkë kreditimit dhe mikro-kredive me kamata më të ulëta.
- Komisioni qendror për mundësi të barabarta në mes grave dhe burrave dhe mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, të hartojnë dhe zbatojnë programe dhe strategji afatgjata të cilat do të mund të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese të sjelljes për rolet e burrave dhe të grave në shoqëri.
- Mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe organizatat joqeveritare ta bëjnë monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe strategjive të hartuara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave.
- Ndryshimet e mëdha kërkojnë intervenime jo konvencionale, në shumë shoqëri gratë janë fuqizuar me anë të mekanizmave financiare që do të çojnë sistemin patriarkal të ndryshoj. Në këtë kontekst një tatim preferencial (më i ulët) në pronë nëse pronar është gruaja do të ishte një qasje për të josh familjet të bartin pronën tek vajza apo gruaja.

VIII. BURIME TË KONSULTUARA

- Kushtetuta e RM
- Ligji mbi Familjen, Gazeta zyrtare e RM, nr.153 nga viti 2004 Ligji mbi pronën
- Ligji për mundësi të barabarta në mes burrave dhe grave, Gazeta Zyrtare e RM, nr.06/2012 nga viti 2012
- Ligji mbi trashëgiminë
- Ligi mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Gazeta zyrtare e RM, nr.35 nga viti 2010
- Human Development Report, UNDP 1997
- Engendering Development, World Bank 2001

IX. ANEKS

PYETËSOR I STRUKTUARUAR

NË KORNIZA TË PROJEKTIT “PËRFORCIMI EKONOMIK I GRUAS NE REONIN E POLLOGUT NËPËRMJET AVOKIMIT DHE PROMOVIMIT TË DREJTËS SË PASURISË”

I.TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË ANKETUARIT

1. Përkatësia etnike

1. Maqedonase
2. Shqiptare
3. Turke
4. Rome
5. Serbe
6. Vllehe
7. Boshnjake
8. Tjetër _____

2. Vendbanimi (vendi i banimit)

1. Vendbanimi Urban _____
2. Vendbanimi Rural _____

3. Moshë

1. 18 -25 vjet
2. 26 – 33 vjet
3. 34 – 41 vjet
4. 42 – 49 vjet
5. 50 + vjet

4. Statusi martesor :

1. E pamartuar
2. E martuar
3. E divorcuar
4. E vejë
5. Në bashkësi jashtmartesore

5. Statusi i punësimit :

1. E punësuar në sektorin publik
2. E punësuar në sektorin privat
3. E punësuar në shoqërinë qytetare (sektori joqeveritarë)
4. Fermer
5. Amvise
6. E pensionuar
7. Nxënëse, Student
8. E papunësuar
9. Tjetër

6. Arsimimi

1. Të pambaruar shkollën fillore
2. Të mbaruar shkollën fillore

3. Të mbaruar shkollën e mesme
4. Të mbaruar shkollën e lartë (Fakultetin)
5. Të mbaruar Studimet Posdiplomike (Magjistratën apo Doktoraturën)

7. A keni Leje për Vozitje:

1. Po
2. Jo

8. A jeni Pronarë apo Ko-Pronarë në biznes

1. Po
2. Jo

Nëse përgjigja është Po sqaroni

9. Familja: Sa anëtarë numëron familja Juaj (rethoni njëren nga alternativat e dhëna)

1. Deri 2 anëtarë
2. Prej 3 deri në 4 anëtarë
3. Prej 5 deri në 6 anëtarë
4. Më shumë se 6 anëtarë

10. Statusi ekonomik (Neto të hyrat në familjen e Juaj për vitin 2016). Në familjen Time të hyrat Neto mujore gjithsej janë:

1. Deri 9.000 denarë
2. Prej 9.001-15.000 denarë
3. Prej 15.001-21.000 denarë
4. Prej 21.001-27.000 denarë
5. Prej 27.001-35.000 denarë
6. Prej 35.001-41.000 denarë
7. Më shumë se 41.001 denarë

11. Në familjen Time të punësuar janë:

1. Dy bashkëshortët
2. Vetëm bashkëshorti im
3. Vetëm unë
4. Asnjëri nga bashkëshortët
5. Fëmijët

12. Në emër të kujt është e regjistruar pasuria e familjes Suaj /jeta bashkëshortore (shtëpi, banesë, tokë etj)

1. Bashkëshortit –Babait
2. E imja – Nëna
3. E përbashkët e bashkëshortëve
4. Fëmijëve
5. Tjetër (sqaroni)_____

13. Nëse keni në pronësi (emri juaj apo të përbashkët) Pasuri e patundshme si është e fituar ajo pasuri (rretho një ose më shumë përgjigje)

1. Trashëgim nga prindët (të falur)
2. Marrëveshje për blerje
3. Dhuratë
4. Trashëgimi nga bashkëshorti
5. Grant nga shteti –Dhuratë
6. Mënyrë tjetër (sqaro)_____

II.Qëndrime

14. Ju lutem analizoni dhe vlerësoni këto përfundime (rrethoni) me numër kush është më i afërt me mendimin dhe qëndrimin Tuaj në lidhje me pronën e pasurisë së patundshme :

QËNDRIM	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem	Nuk kam mendim
1. Prona e pasurisë së patundshme e përmirëson statusin social të gruas në familje dhe bashkësi	1	2	3	4
2.Prona e pasurisë së patundshme është menyrë e sigurisë për në pleqëri.	1	2	3	4
3. Prona e pasurisë së patundshme e përmirëson vetëbesimin te gruaja	1	2	3	4
4. Prona e pasurisë së patundshme rit mundësinë për dhunë në familje	1	2	3	4
5. Prona e pasurisë së patundshme e zvogëlon mundësinë për dhunë në familje	1	2	3	4

15. Renditni prej 1 deri 9 arsyet përse gratë në bashkësinë Tuaj nuk kërkojnë pronë trashëguese nga prindërit e tyre : Me 1 radhitni arsyen më pak rëndësishme ndërsa me 9 arsyen më të rëndësishme.

Nr.	Arsyet nga të cilat gruaja NUK kërkon pronë trashëguese nga prindërit e vet	Arsye më pak kryesore 1
		Arsyja më kryesore 9
1	Pasi që mendon se është vendim i drejtë	
2	Nga tradita	
3	Nga normat religjioze	
4	Që të largohen mosmarëveshjet me trashëgimtarët e tjerë (vëllezërit)	
5	Mungesë vetëbesimi	
6	Mungesë e ndërgjegjes / vetëdisimit	
7	Nga mungesa e dijes për të drejtat trashëguese	
8	Nga friga që në rast divorci nuk do mund të kthehen për të jetuar tek prindërit	
9	Tjetër (sqaroni)	

16. Ju lutem analizoni dhe vlerësoni këto përfundime (rrethoni) me numër kush është më i afërt me mendimin dhe qëndrimin Tuaj në lidhje me pronën :

QËNDRIM	Pajtohem	Neutral	Nuk pajtohem	Nuk kam mendim
1.Vajza duhet të marrë të njëjtin trajtim në procedurën e trashëgimisë nga prindërit	1	2	3	4
2.Vajza nuk duhet të marrë më shumë se ½ nga ajo që fitojnë trashëgimtarët tjerë	1	2	3	4
3. Vajza nuk duhet të marrë pronë në bazë të trashëgimisë nga prindërit(prindër,vëllezër)	1	2	3	4

4. Deklarata positive e trashëgueses negativisht do të ndikojë në raportet me familjen time primare(prindër,vëllezër)	1	2	3	4
5. Deklarata positive e trashëgueses pozitivisht do të ndikojë në raportet me familjen time primare(prindër,vëllezër)	1	2	3	4

17. Ju lutem analizoni dhe vlerësoni këto përfundime (rrethoni) me numër kush është më i afërt me mendimin dhe qëndrimin Tuaj në lidhje me procesin e sjelljes së vendimeve në jetën bashkëshortore për:

Mënyra e sjelljes së vendimeve	Bashkëshorti (do duhej të vendos)	Unë (do duhej të vendos)	Bashkërisht(do të duheshte të vendosim)	Nuk kam mendim
1.Në familjen time për mënyrën e modeleve për kursim vendos.....	1	2	3	4
2.Në familjen time për aplikim për kredi vendos.....	1	2	3	4
3.Kur blejmë/shesim pasuri të patundshme vendos.....	1	2	3	4
4.Për mënyrën e harxhimve për festimet / gëzimet familjare vendos.....	1	2	3	4

III. Trashëgimia

18. A keni fituar pasuri në bazë të trashëgimisë nga prindërit tuaj:

- 1) Po 2)Jo

18.1. Përderisa përgjigja është Po, tregoni arsyet:

- 1) Tradita e familjes sonë
- 2) E drejtë ligjore
- 3) Mendoj që kam të drejtë në trashëgimi
- 4) Presion nga bashkëshorti /familja e bashkëshortit
- 5) Gjendja e rëndë finansiare
- 6) Tjetër_____

18.2. Përderisa përgjigja e pyetjes së mëparshme është Jo, ju lutem tregoni arsyet:

- 1) Nuk është traditë në familjen tonë
- 2) Nuk kam të drejtë në at pronë
- 3) Presion nga trashëgimtarët tjerë
- 4) Frigë nga ndërprerja e raporteve në familje
- 5) Gjendja e mirë finansiare

6) Tjetër _____

19. A keni përkrahje nga prindërit tuaj për të drejtën e trashëgimisë:

- 1) Kam përkrahje të madhe nga prindërit
- 2) Kam përkrahje
- 3) Neutrale
- 4) Kam pak përkrahje
- 5) Nuk kam aspak përkrahje
- 6) Nuk kam mendim

20. Nëse keni fëmijë ose (kur do të kishit fëmijë) kush do ta trashëgon pronën:

- 1) Djali /Djemt
- 2) Vajza /Vajzat
- 3) Në mënyrë të barabartë e ndarë ndërmjet djalit dhe vajzës
- 4) Vajza do merte pjesë më të vogël në krahasim me djalin
- 5) Nuk e di
- 6) Tjetër

20. Nëse trashëgimtare e vetme në familje është vajza e juaj kush do ta trashëgojë pronën tuaj:

- 1) Vajza do ta mer trashëgiminë
- 2) Trashëgimia do jetë e ndarë në mes anëtarëve djem në familjen më të gjërë të bashkëshortit (Daja/Axha,kusherinjtë)
- 3) Nuk e di

21. A egziston në familjen apo bashkësinë tuaj rast kur vajza e ka trashëgu pronën familjare:

- 1) Po, në bashkësinë time
- 2) Po, në familjen time
- 3) Asnjëherë, as që do të ndodh në të ardhmen
- 4) Jo, por pres në të ardhmen të ketë raste të tilla
- 5) Nuk e di